



REPUBLIKA E SHQIPERISE
Ministria e Punëve Publike dhe Transportit
MINISTRI

URDHËR

Nr. 83, Datë 9.9.2011

PËR

CAKTIMIN E FUNKSIONIT TË KORDINIMIT TË SLOTEVE APO
RREGULLIMIT TË ORARAVE NË AEROPORTE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, dhe në zbatim të nenit 60 dhe 61 të Ligjit 10 040 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Funkcionet e kordinimit të slotëve apo të rregullimit të orarëve në aeroporte do të kryhen nga stafi i Drejtorisë së Politikave të Transportit Ajror në Ministri e cila është struktura e vetme përgjegjëse për alokimin e slotëve apo rregullimin e orarëve në aeroportet e Republikës së Shqipërisë.
2. Gjatë ushtrimit të këtij funksioni stafi përkatës duhet të veprojë në përputhje me rregullat transparente, asnjënjëse dhe jodiskriminuese dhe ngarkohet të japë leje për të përdorur gamën e plotë të infrastrukturës aeroportuale, të nevojshme për të operuar një shërbim ajror, në një datë dhe kohë të caktuar, për qëllimin e uljes apo të ngritjes së avionëve.
3. Ngarkohen të gjithë subjektet operuese dhe rregullatore në fushën e aviacionit civil, për zbatimin e këtij urdhri
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në fletoren zyrtare

SOKOL OLLDASHI

MINISTËR